**URDHËR**
**Nr. 316, datë 31.10.2012**

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHRIT NR. 5, DATË 9.1.2012 "PËR PËRDITËSIMIN E CERTIFIKATAVE VETERINARE, TË CILAT SHOQËROJNË NGARKESAT E USHQIMEVE ME ORIGJINË SHTAZORE, SI DHE NGARKESAT E USHQIMEVE PËR KAFSHË PRODHUESE TË USHQIMIT, DHE TË CILAT HYJNË NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 55 të ligjit nr. 10 465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë" dhe nenit 18 të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 "Për ushqimin",

URDHËROJ:

1. Urdhri nr. 5, datë 9.1.2012 "Për përditësim e certifikatave veterinare, të cilat shoqërojnë ngarkesat e ushqimeve me origjinë shtazore, si dhe ngarkesat e ushqimeve për kafshë prodhuese të ushqimit dhe të cilat hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë", shfuqizohet me qëllim përmirësimin dhe përshtatjen e tyre në përputhje me nevojat e tregut.

2. Drejtoria e Shërbimit Veterinar dhe Drejtoria e Sigurisë Ushqimore të ndjekin procedurat për njoftimin e këtij urdhri pranë autoriteteve homologe të vendeve anëtare të OIE-së, si dhe pranë OBT-së.

3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Veterinar, Drejtoria e Sigurisë Ushqimore, si dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SË KONSUMATORIT
**Genc Ruli**